

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Matura 2021

UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E PËRGJIGJEVE TË NXËNËSVE

SESIONI I

LËNDA: GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Varianti A

Arsimi i orientuar (artistik dhe sportiv) dhe profesional

Udhëzime të Përgjithshme

Në testin e gjuhës shqipe dhe letërsisë përdoren dy lloje pyetjesh, të cilat vlerësojnë kompetencat e të nxëniet për secilin nxënës. Një nga llojet është pyetja me alternativa, ku nxënësit do të zgjedhin atë alternativë që i përgjigjet pyetjes. Çdo pyetje e këtij lloji ka një përgjigje të vetme të saktë. Përgjigjet e pyetjeve me alternativa do të vlerësohen në mënyrë elektronike.

Lloji tjetër i pyetjeve është ai me shtjellim, ku nxënësi e shkruan përgjigjen në hapësirën e përcaktuar në test. Këto pyetje vlerësohen nga vlerësues, të cilët do të përdorin udhëzimet e pikëzimit të përshkruara në vijim të këtij manuali.

Qëllimi i këtij materiali është të sigurojë për vlerësuesit informacionin dhe udhëzimet për shpërndarjen e pikëve, të nevojshme për të caktuar në mënyrë të besueshme dhe të vlefshme vlerësimin e përgjigjeve të secilit nxënës.

Secila prej pyetjeve me shtjellim ka një vlerë pikësh prej 1 (një), 2 (dy) ose 3 (tre) pikë, në varësi të thellësisë së të kuptuarit ose shkallës së mbështetjes tekstuale që kërkon pyetja.

Udhëzuesi i pikëzimit përshkruan aspekte të veçanta të përgjigjes për çdo pyetje. Secila pyetje e testit ka udhëzuesin e vet, të përshtatur për elemente specifike të saj. Megjithatë ekzistojnë disa pika të përbashkëta tek të gjithë udhëzuesit. Për shembull, niveli më i ulët i pikëve, në secilin udhëzues, është 0 pikë. Në këtë rast përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi nuk ka kuptuar një aspekt të caktuar të tekstit që po vlerësohet nga pyetja. Përgjigjet që marrin një vlerësim me 0 pikë, mund tregojnë se teksti ose pyetja janë kuptuar keq, ose ato përfshijnë informacione aq të paqarta, sa vendosja e një pike më të lartë nuk mund të justifikohet.

Në test ka pyetje ku nxënësit do të përgjigjen në mënyra të ndryshme. Prandaj, do të ishte e papërshtatshme që të vendoset në udhëzues një përgjigje specifike, unike, që pritet të japin në test të gjithë nxënësit. Është përgjegjësia e vlerësuesit dhe më pas e komisionit të vlerësimit, që të marrë parasysh përgjigjen që nxënësi ka dhënë, dhe ta vlerësojë atë si të plotë, të pjesshme apo të pasaktë.

Në testin e gjuhës shqipe dhe letërsisë idetë e dhëna nga nxënësit dhe larmia e interpretimeve që ata sjellin për secilën pyetje, çon në shumë përgjigje të paparashikueshme. Udhëzuesi i pikëzimit dhe shembujt e dhënë në të duhet të jenë gjithmonë baza për secilin vendim që komisioni i vlerësimit do të japë. Megjithëse ne i inkurajojmë vlerësuesit që t'i lexojnë përgjigjet e nxënësve në mënyrë mbështetëse, domethënë që mund të lejojnë gabime të vogla ose mungesë qartësie, është e domosdoshme që vlerësuesit të mos interpretojnë mbi përgjigjet e dhëna nga nxënësit. Ata nuk duhet të supozojnë se çfarë donte të thoshte nxënësi në përgjigjen e tij. Vlerësuesit duhet ta vlerësojnë secilën përgjigje të nxënësit sipas përgjigjes konkrete që ka dhënë ai. Në fund të fundit, kjo është mënyra më e drejtë, e besueshme dhe e vlefshme për pikëzimin e përgjigjeve të nxënësve për këto lloje pyetjesh.

Pjesa I – Gjuhë shqipe

Ndotja plastike

| | | |
|----------|---|--------|
| Pyetja 1 | D | 1 pikë |
| Pyetja 2 | B | 1 pikë |
| Pyetja 3 | A | 1 pikë |
| Pyetja 4 | B | 1 pikë |

Pyetja 5 (a) 1 pikë

Cilat janë karakteristikat e vendeve që, sipas tekstit, kontribuojnë më shumë në ndotjen plastike?

| |
|--|
| 1 pikë: Përgjigje e plotë |
| <p>Përgjigjja identifikon nga lista më poshtë, më shumë se një karakteristikë të atyre vendeve, që ndikojnë në ndotjen plastike.</p> <p><i>Shembuj:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Vende të zhvilluara.</i> • <i>Dendësi e konsiderueshme e popullsisë.</i> • <i>Vende bregdetare.</i> |
| 0 pikë: Përgjigje e papranueshme |
| <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Pyetja 5 (b) 1 pikë

Sipas studimeve të kryera, ku gjendet më shumë plastika?

| |
|---|
| 1 pikë: Përgjigje e plotë |
| Përgjigjja identifikon fundin e oqeaneve si vendin ku gjendet më shumë plastika. <i>Shembull:</i> <ul style="list-style-type: none">• Në fundin e oqeaneve. |
| 0 pikë: Përgjigje e papranueshme |
| Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë. <ul style="list-style-type: none">• Në oqean/e. |

QSHA 2021

Pyetja 6 (a) 2 pikë

Analizoni **titullin** dhe **nëntitullin** e kësaj pjese nga pikëpamja e rolit që luajnë në këtë shkrim.

| |
|---|
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja analizon titullin e tekstit, duke theksuar se ai shërben për të na fokusuar drejtpërdrejt te tema, OSE te përmbajtja e tekstit.</p> <p><u>Titulli:</u></p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Është i përmbledhur në një grup emëror, të çon në mënyrë të drejtpërdrejtë te referenti /problemi/çështja/tema.</i> • <i>Vjen në formë të përmbledhur dhe na tregon se për çfarë do të flasë teksti në vijim.</i> • <i>Na tregon në formën më të shkurtër mbi përmbajtjen e tekstit.</i> |
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja analizon nëntitullin dhe fokusohet në faktin se ai lidh titullin me tekstin në vijim, OSE jep disa detaje më të plota në lidhje me çështjen që do të trajtojë teksti.</p> <p><u>Nëntitulli:</u></p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Siguron lidhjen e titullit me tekstin.</i> • <i>Ndërmjetëson për të lidhur në mënyrë të natyrshme titullin me tekstin.</i> • <i>Jep detaje plotësuese, lidhur me çështjen/problemin kryesor që do të trajtojë teksti në vijim.</i> |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 6 (b) 2 pikë

Me çfarë toni është shkruar ky tekst? Cila është arsyeja e përdorimit të këtij toni?

| |
|--|
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja identifikon tonin e përdorur në tekst, sipas shembujve të listës më poshtë (ose shembuj sinonimë me to).</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>autoritar,</i> • <i>i paanshëm,</i> • <i>serioz,</i> • <i>i pakundërshtueshëm.</i> |
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja shpjegon arsyen e përdorimit të këtij toni, e cila lidhet me natyrën e tekstit, OSE me organizimin e tij mbi bazë të fakteve apo të të dhënave.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Sepse është tekst shpjegues (infor-paraqitës) dhe ky lloj toni është karakteristik për këtë lloj teksti.</i> • <i>Sepse parashtron fakte, të dhëna të pakundërshtueshme, serioze.</i> • <i>Autori nuk shpreh opinionet e tij.</i> • <i>Autori nuk mban qëndrim për çështjen e parashtruar/ është i paanshëm.</i> |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Pyetja 7 **1 pikë**

Në fjalinë e mëposhtme kemi një raport shkak-pasojë.

Në një kohë kur nuk ka asnjë plan menaxhimi të qartë, numri ka gjasa të dyfishohet në vitin 2025, pohon inxhinieri i mjedisit.

| |
|--|
| 1 pikë: Përgjigje e plotë |
| Përgjigjja identifikon shkakun dhe pasojën në fjalinë e dhënë. |
| Shembuj: |
| <ul style="list-style-type: none"> • <i>Shkaku: Nuk ka asnjë plan menaxhimi të qartë.</i> • <i>Pasoja: Numri ka gjasa të dyfishohet në vitin 2025.</i> |
| 0 pikë: Përgjigje e papranueshme |
| Përgjigjja gjen vetëm shkakun OSE vetëm pasojën. |
| Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë. |

Pyetja 8 **1 pikë**

Një nxënës që e lexoi këtë artikull, u shpreh: *Shëndeti ynë rrezikohet seriozisht nga ndotja plastike.*

Cili nga informacionet e tekstit e mbështet këtë pohim?

| |
|--|
| 1 pikë: Përgjigje e plotë |
| Përgjigjja identifikon informacionin e cituar drejtpërdrejt ose të perifrazuar, që mbështet pohimin e dhënë. |
| Shembull: |
| <ul style="list-style-type: none"> • <i>...plastika lëshon toksina që kalojnë në trupin e peshqve, të cilët mund të bien në rrjetat e peshkimit dhe të përfundojnë si ushqim në tavolinat tona.</i> |
| 0 pikë: Përgjigje e papranueshme |
| Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë. |

Pyetja 9 2 pikë

A është ky tekst një burim informacioni i paanshëm? Argumentoni mendimin tuaj, duke iu referuar tekstit.

| |
|---|
| <p>2 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja është PO dhe argumenton duke u bazuar në llojin e tekstit, i cili kërkon një informacion të tillë, të paanshëm OSE në qëndrimin e autorit, i cili nuk shfaqet në këtë tekst. Argumenti mbështetet me të dhëna nga teksti, që provojnë qëndrimin e mbajtur nga nxënësi.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Po, është i paanshëm. Teksti info-paraqitës (shpjegues) ndërtohet mbi informacione, vërtetësia e të cilave është e provuar. P.sh.: “Sipas studimit, afërsisht 75000 tonë mbetje plastike amerikane hyjnë çdo vit në oqeanë përmes tokës.”</i> • <i>Nuk ka asnjë qëndrim personal apo opinion të autorit. Mbështetet mbi studime të të tjerëve. (provat, referencat.....). P.sh.: “Në një kohë kur nuk ka asnjë plan menaxhimi të qartë, numri ka gjasa të dyfishohet në vitin 2025, pohon inxhinieri i mjedisit”.</i> |
| <p>1 pikë: Përgjigje e pjesshme</p> <p>Përgjigjja është PO dhe argumenton duke u bazuar në llojin e tekstit, i cili kërkon një informacion të tillë, të paanshëm OSE në qëndrimin e autorit, i cili nuk shfaqet në këtë tekst. Argumenti nuk mbështetet me të dhëna nga teksti, që provojnë qëndrimin e mbajtur nga nxënësi.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Mbështetet mbi studime të të tjerëve.</i> • <i>Është tekst i paanshëm, ku mungon opinioni i autorit.</i> • <i>Është tekst që ndërtohet mbi informacione, vërtetësia e të cilave është e provuar.</i> |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjet vetëm PO.</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Po.</i> • <i>Po, është i paanshëm (përsëriti trungun e pyetjes).</i> |

Pyetja 10 2 pikë

Në tekst ofrohen dy mënyra për të zgjidhur problemin e shkaktuar nga ndotja plastike.

Cilat janë ato?

| |
|---|
| 2 pikë: Përgjigje e plotë |
| Përgjigjja identifikon dy mënyra nga lista e dhënë më poshtë. <i>Shembuj:</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Grumbullimi dhe kontrolli i mbetjeve.</i> • <i>Menaxhimi i lumenjve.</i> • <i>Riciklimi i mbetjeve.</i> |
| 1 pikë: Përgjigje e pjeshme |
| Përgjigjja identifikon vetëm një nga mënyrat e mësipërme. |
| 0 pikë: Përgjigje e papranueshme |
| Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë. |

Pinguinët

| | | |
|------------------|----------|---------------|
| Pyetja 11 | B | 1 pikë |
| Pyetja 12 | D | 1 pikë |
| Pyetja 13 | B | 1 pikë |
| Pyetja 14 | C | 1 pikë |
| Pyetja 15 | D | 1 pikë |
| Pyetja 16 | D | 1 pikë |
| Pyetja 17 | C | 1 pikë |
| Pyetja 18 | B | 1 pikë |
| Pyetja 19 | A | 1 pikë |
| Pyetja 20 | C | 1 pikë |

Pjesa II- Letërsi

Migjeni - Kanga e rinis

| | | |
|-----------|---|--------|
| Pyetja 21 | D | 1 pikë |
| Pyetja 22 | C | 1 pikë |
| Pyetja 23 | D | 1 pikë |

Pyetja 24 **2 pikë**

Përshkruani atmosferën e poezisë, duke nënvizuar edhe disa nga fjalët kyç që e krijojnë atë.

| |
|--|
| <p>2 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja përshkruan atmosferën që sundon në poezi, duke dhënë fillimisht thelbin e saj, që është <i>gëzimi, drita</i> apo sinonime me listën e fjalëve të dhëna në shembujt më poshtë. Përshkrimi bazohet në disa <i>fjalë kyç</i> të marra nga vargjet e poezisë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>entuziazëm,</i> • <i>plot shpresë,</i> • <i>jetë dhe ngjyra,</i> • <i>gëzim, frymëmarrje,</i> • <i>besim,</i> • <i>dashuri për jetën,</i> • <i>padurim për ndryshim.</i> <p><u>Fjalët kyç:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>këngë, rini, vrull, shpërthen, gëzim, zjarr, kumbim, ndjenjë, qeshje, diell etj.</i> |
| <p>1 pikë: Përgjigje e pjeshme</p> <p>Përgjigjja përshkruan atmosferën, por pa dhënë fjalët kyç.</p> |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Pyetja 25 (a) 2 pikë

Zbuloni shkallëzimin e përdorur *në strofën e dytë*. Cili është funksioni i tij?

| |
|---|
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja identifikon shkallëzimin në strofën e dytë.</p> <p>Shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Të rroki, të puthi, të nxisi ...të na mbysi dallga.</i> |
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja zbërthen funksionin që luan ky përdorim.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Shkallëzimi i foljeve tregon shkallëzim të veprimit, që përkon me shkallëzimin e gjendjes shpirtërore të poetit përballë ndryshimit.</i> • <i>Shkallëzimi i fjalëve (foljeve) synon shkallëzimin e emocionit tek lexuesi, për shkak të imazhit në lëvizje, i cili krijohet nga kalimi gradual i ndjenjës: nis me përqaftimin, vijon me puthjen, që nxit dashurinë e zjarrtë, e finalizohet me tronditjen që shkakton dallga e ndjenjave që ngacmon kënga.</i> • <i>Kënga në vetvete vjen si simbolikë e ndryshimit. Ky i fundit jepet me imazhin lëvizës të përdorimit të tri foljeve, ku njëherë kënga të rrok, më pas të puth dhe në fund të nxit (me dashnu). Më pas dallga e krijuar nga kënga, të mbyt duke përforcuar imazhin e diçkaje të thellë që sjell ndryshim.</i> |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25 (b) 2 pikë

Zbërtheni nëntekstin për secilin nga vargjet:

e na të duem fort si duem një diell.

| |
|--|
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja zbërthen nëntekstin e vargut: <i>të duash ashtu si do diellin</i>. Ajo do të fokusohet në fjalën kyç që është <i>dielli</i>, simbolikën që mbart dhe analogjinë me dashurinë për rininë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Dashuria për rininë krahasohet me dashurinë për diellin, dëshirën për diellin si burim jete, drite, ngrohtësie, që shndërrohet në nevojë dhe domosdoshmëri.</i> • <i>Rinia është jeta, ashtu siç është dhe dielli jeta për çdo qenie në tokë. Nuk jetohet dot pa diell, nuk jetohet dot pa rininë.</i> • <i>Rina ndriçon të ardhmen, ashtu siç ndriçon drita e diellit.</i> |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Vazhdim

Zbërtheni nëntekstin për secilin nga vargjet:

... qeshu si fëmi

| |
|---|
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja zbërthen nëntekstin e vargut: <i>qeshu si fëmi</i>. Thelbi i saj duhet të lidhet me zbërthimin e simbolikës që mbart fjala kyç <i>fëmi</i>, si dhe krahasimin e gazit të fëmijës me rininë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Qeshja e fëmijës është pafajësia vetë. Buzëqeshja e tij është gjithë dritë dhe rrezaton mirësi e dashuri.</i> • <i>Krahasimi ka për bazë thelbin që mbart buzëqeshja e fëmijës: pastërtinë, dritën, pafajësinë. Të tillë e sheh edhe poeti të qeshurën e rinisë.</i> |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 26 2 pikë

Gjeni fjalën ku është përdorur “në mënyrë të gabuar” shkronja e madhe.

Shpjegoni funksionin artistik të kësaj zgjedhjeje nga ana e autorit.

| |
|---|
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja identifikon fjalën Rini.</p> <p>Shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Rini.</i> |
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja zbërthen funksionin e kësaj zgjedhjeje që është rëndësia që autori i jep kësaj fjale.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Funksioni: emri i përgjithshëm shndërrohet në të përveçëm për t'i dhënë më shumë rëndësi, forcë.</i> • <i>Ai shndërrohet nga emër abstrakt/ i përgjithshëm, në emër konkret (i përveçëm – frymor), me të cilin mund të krijohet një raport më i ngushtë, më i prekshëm.</i> • <i>E konsideron si një person, me të cilin krijon një komunikim të drejtpërdrejtë.</i> |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>e bën të rëndësishëm (e paplotë).</i> • <i>e bën të përveçëm (e paqartë).</i> |

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 27 2 pikë

Komentoni vargun e fundit të poezisë: *Qeshu, rini! Qeshu! Bota asht e jote.*

| |
|---|
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja komenton vargun e dhënë, ku së pari theksohet imazhi i krijuar dhe më pas mënyra se si poeti e ka krijuar atë. Në koment duhet të përfshihen figura/t e stilistikës: përsëritja/metonimia/metafora; toni nxitës që mbart vargu apo koha e foljes.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Është vargu përmbledhës i të gjithë idesë së poezisë. Bota (e ardhmja) i takon rinisë; përdorimi i së tashmës së gjithëkohshme ndihmon për të ngjizur më fort raportin Botë-Rini (metafora/ metonimia). Komunikimi i unit lirik është në vetën II, përsëritja e foljes qeshu si dhe toni nxitës, parathënë ndryshimin që autori e sheh të realizuar (folja është). • Poeti i drejtohet drejtpërsëdrejti rinisë. Ai e nxit atë të qeshë, madje e përforcon këtë, duke e përsëritur dy herë foljen. Ky gaz, kjo e qeshur e ka burimin tek shpresa për të ardhmen. Pjesë e saj është rinia (të rinjtë -metonimi), së cilës i takon Bota, e ardhmja (metonimi.) |
| <p>1 pikë: Përgjigje e pjesshme</p> <p>Përgjigjja jep një koment që përcakton imazhin, por nuk tregon mënyrën si autori e krijon atë.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vargu na nxit të përfytyrojmë një rini plot jetë, së cilës i takon e ardhmja. • Bota është për rininë, që i jep kuptim asaj. Ndaj poeti i drejtohet asaj. |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Hygo - Katedralja e Parisit

| | | |
|-----------|---|--------|
| Pyetja 28 | C | 1 pikë |
| Pyetja 29 | A | 1 pikë |
| Pyetja 30 | A | 1 pikë |

Pyetja 31 (a) **2 pikë**

Identifikoni *në paragrafin e parë* dy detaje që tregojnë gjendjen fizike të Esmeraldës.

| |
|--|
| 2 pikë: Përgjigje e plotë |
| Përgjigjja fokusohet vetëm në paragrafin I, ku identifikon dy detaje nga lista e dhënë më poshtë. |
| Shembuj: |
| <ul style="list-style-type: none"> • <i>e alivanosur,</i> • <i>qepallat i hapeshin i mbylleshin,</i> • <i>sikur ngjitej në ajër,</i> • <i>qëndronte pezull,</i> • <i>dikush e ngrinte lart.</i> |
| 1 pikë: Përgjigje e pjesshme |
| Përgjigjja identifikon, vetëm në paragrafin I, një detaj nga lista e mësipërme. |
| 0 pikë: Përgjigje e papranueshme |
| Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë. |

Pyetja 31 (b) **1 pikë**

Shpjegoni pse Esmeralda i bindet verbtazi Kuazimodos.

| |
|--|
| 1 pikë: Përgjigje e plotë |
| Përgjigjja shpjegon arsyen pse Esmeralda i bindet verbërisht Kuazimodos, ku theksohet gjendja e saj fizike. |
| Shembuj: |
| <ul style="list-style-type: none"> • <i>Për shkak të gjendjes fizike.</i> • <i>Ajo ishte e alivanosur.</i> • <i>Nuk kuptonte ç'ndodhte me të.</i> • <i>Ishte e pavullnetshme, e përhumbur, kishte frikë.</i> |
| 0 pikë: Përgjigje e papranueshme |
| Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë. |
| <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ajo nuk e donte.</i> • <i>Ajo donte të ikte.</i> |

Pyetja 32 3 pikë

Çfarë provon Kuazimodo për Esmeraldën? Përgjigjen shoqërojeni edhe me ilustrime nga fragmenti.

1 pikë: Përgjigje e plotë

Përgjigjja identifikon ndjenjën që Kuazimodo provon për Esmeraldën, sipas shembujve të dhënë më poshtë apo të tjerë shembuj, sinonimë me to.

Shembuj:

- *dhimbje,*
- *trishtim,*
- *dashuri,*
- *adhurim.*

0 pikë: Përgjigje e papranueshme

Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.

Vazhdim

Ç'tregon kjo për natyrën e tij?

| |
|---|
| 1 pikë: Përgjigje e plotë |
| <p>Përgjigjja tregon se nxënësi e ka kuptuar thelbin e natyrës së Kuzimodos dhe duhet të theksojë ndjeshmërinë e tij.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>i ndjeshëm,</i> • <i>ka një shpirt të butë,</i> • <i>shfaqet plot me ndjenja.</i> |
| 0 pikë: Përgjigje e papranueshme |
| <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Vazhdim

Ilustrimet:

| |
|---|
| 1 pikë: Përgjigje e plotë |
| <p>Përgjigjja përzgjedh nga fragmenti ilustrimet që tregojnë thelbin e natyrës së Kuazimodos.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>ai e shikoi me një trishtim të thellë,</i> • <i>duart e tij të mëdha që po i zgjidhnin me kujdes litarin që i vriste krahët,</i> • <i>Ai e vështroi atë plot ankth.</i> |
| 0 pikë: Përgjigje e papranueshme |
| <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 33 1 pikë

Në fjalinë e parë të **paragrafit të dytë**, gjeni një tipar të romantizmit evropian, bashkë me ilustrimin përkatës.

1 pikë: Përgjigje e plotë

Përgjigjja identifikon një tipar të romantizmit, që shfaqet në fjalinë e paragrafit II, bashkë me shembullin përkatës.

Fjala ku do të identifikohet tipari me shembullin është:

Por, kur kambanari flokëhallakatur e shpuri atë, duke gulçuar, në qelinë e strehimit, kur pa duart e tij të mëdha që po i zgjidhnin me kujdes litarin që i vriste krahët, ajo ndjeu atë lloj tronditjeje që e zgjon befas në mes të natës pasagjerin e një anijeje, kur ajo ngec në një cekëtinë.

Shembuj:

- **Kontrasti:** duart e mëdha- zgjidhin me kujdes litarin, ai dhe ajo.
- **Pamja me thelbin:** flokëhallakatur dhe zemra e madhe.
- **Heroi i jashtëzakonshëm i ndodhur në situatë të jashtëzakonshme:** Kuazimodo, Esmeralda.
- **Figuracioni:** p.sh: kambanari flokëhallakatur.
- **Kulti i ndjenjës-** e zbërthen litarin me kujdes.

0 pikë: Përgjigje e papranueshme

Përgjigjja identifikon tiparin, por nuk e ilustron me shembullin e duhur ose ilustrimi mungon.

Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.

Pyetja 34 (a)

1 pikë

Cila është arsyeja që, në fund të fragmentit, Kuazimodo nuk i përgjigjet Esmeraldës?

| |
|--|
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja thekson se Kuazimodo e kupton se dashuria, ndjenja e tij për Esmeraldën, nuk kuptohet prej saj.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Mbetet i pagojë, pasi ndihet i pafuqishëm përballë saj.</i> • <i>Ai e kupton që dashuria e tij nuk do të merrte kurrë përgjigje.</i> • <i>Ai e kupton se Esmeralda nuk do ta njihte kurrë shpirtin e tij.</i> • <i>Ai e ndien se ajo nuk e kupton, as atë, as ndjenjën e tij.</i> • <i>Trishtimi në sytë e tij është më shumë trishtim për fatin e tij.</i> • <i>Është shenjë e nënshtrimit të tij absolut.</i> |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>I vjen keq për të. (e pavend)</i> • <i>Ajo nuk e do. (e paqartë)</i> • <i>I duhet të shkojë.</i> |

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 34 (b) 2 pikë

Me çfarë toni i thotë Esmeralda fjalët:

Pse më shpëtuat?

| |
|--|
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja përcakton tonin me të cilin Esmeralda e pyet Kuazimodon dhe që, në thelb, është <i>dhimbje</i> (ose sinonime me të).</p> <p><u>Toni:</u></p> <p><i>Shembuj:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dhimbje,</i> • <i>trishtim,</i> • <i>dëshpërim.</i> |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Vazhdim

Interpretoni nëntekstin që ato mbartin.

| |
|--|
| <p>1 pikë: Përgjigje e plotë</p> <p>Përgjigjja jep një interpretim personal të nxënësit, ku zërthehet nënteksti i pyetjes së Esmeraldës.</p> <p><i>Shembuj:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ajo nuk gjen më kuptim për jetën, pasi ka kuptuar se Febysi nuk e do dhe ndodhet përballë një turme që kërkon ta ekzekutojë.</i> • <i>Ajo e dëshiron vdekjen për shkak të mungesës së dashurisë.</i> • <i>Është pyetje retorike, pasi ajo realisht nuk pret përgjigje. Esmeralda është e vetëdijshme për shkallën e mjerimit ku ndodhet.</i> • <i>Ajo është e izoluar, dënuar të qendrojë brenda Katedrales. Kjo pamundësi dhe mungesa e shpresës, rrit tronditjen dhe dëshpërimin e saj.</i> |
| <p>0 pikë: Përgjigje e papranueshme</p> <p>Përgjigjja mund të jetë e paqartë, e palidhur me pyetjen ose nxënësi nuk ka shkruar asgjë.</p> |

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur, në përgjigjen e dhënë, jep një formulim të ndryshëm nga modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 35 **8 pikë****Lloji i esesë: argumentuese**

Për vlerësimin e përgjigjeve për pyetjen ese do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton pse ka zgjedhur *një përmbajtje, një formë apo vend të caktuar për posterin*;
- zbërthen argumentet e dhëna përmes **detajesh** të shumëllojshme shpjeguese dhe përshkrimi mbështet shpjegimin përgjatë gjithë shtjellimit;
- përdor referenca bindëse, të mbështetura në burime të shumëllojshme informacioni, të pavarura nga njëra-tjetra;
- sjell përvoja të ndryshme personale, të cilat mbështetin bindshëm argumentin;
- paraqet qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- planifikon me shumë kujdes *hyrjen* (e cila i shmanget së zakonshmes) dhe siguron *kalimin rrjedhshëm* në paragrafët zhvillues;
- parashton qartë zgjedhjen e tij në raport me paraqitjen e posterit;
- shtjellon në mënyrë të plotë idenë e tij, nëpërmjet teknikash shumë të zgjedhura;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përdor një gjuhë shumë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë *tipike argumentuese*, të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- përdor fjalor shumë të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim shumë të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**2 pikë****(sintaksa dhe drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan saktë nga pikëpamja e *drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit*, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive;
- përdor drejt struktura *të thjeshta e të ndërlukuara të fjalive*, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë;
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj, gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Shënim:Për të katër kriteret e paraqitura më sipër, nëse përgjigjet janë të pjesshme, nxënësi do të marrë **1 pikë**.Nëse nxënësi ka shkruar një lloj tjetër eseje (jo argumentuese) ose nuk përmbush asnjë nga kriteret e mësipërme, do të vlerësohet me **0 pikë**.